



ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 62500-20-4269-2-2-1

Sa i përket tenderit për RREGULLIMI I SISTEMIT TË ZERIMIT, PËRKTHIMIT DHE VOTIMIT ELEKTRONIK NË SALLËN E KUVENDIT TË KOMUNES MALISHEVË

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

TETRONIKS LLC

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Bedri Shala, pn, 10000 Prishtine, Kosove

(Adresa)

Prishtine

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

038 722 253

(Numri Telefonit)

038 722 253

(Numri i Faks-it)

Almir Ajeti

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@tetroniks.com

(Adresa elektronike)

19.09.2020


SH.P.K
tetroniks
PRISHTINE - KOSOVE

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

- Njoftimi për kontratë është shpallur me datë 10.08.2020, ndërsa afati për dorëzimin e tenderit është 31.08.2020, ora 14:30.
- Kriteri për dhënie të kontratës është Çmimi më i ulët.
- Me datë 09.09.2020, ora 12:58, përmes prokurimit elektronik kemi pranuar B58 Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe B46 Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm.
- Të njëjtën datë kemi kërkuar nga AK të na lejoj qasje në dokumentacionin tenderues, ndërsa me 11.09.2020 (nga ora 10:00 deri 12:00) AK ka mundur qasje në dokumentacionin tenderues.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Procesverbali i hapjes së tenderit i pranuar në formë elektronike nga platforma elektronike e prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

- Pas pranimit të njoftimit mbi vendimin e AK-së dhe lëtër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm në afat të rregullt kohor kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së, më saktësisht me datë 12.09.2020.
- Me datën 17.09.2020 kemi pranuar vendimin si të pabazuara nga AK-ja si përgjigje ndaj kërkesës sonë.
- Bashkëngjitur janë formulari F02 Kërkesa për Rishqyrtim dhe vendimi AK-së.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 28 – Specifikimet teknike

Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Duke ju referuar procedurës së tenderit me titull dhe numër të prokurimit të lartëpërmendur, ju informojmë se pas kërkesës sonë për të na lejuar qasje në dokumentacion, AK na ka mundësuar qasjen me datë 11.09.2020, ora 10:30. Pas marrjes së dokumentacionit ofertues të OE të përzgjedhur për kontratë dhe analizimit të ofertës teknike, kemi konstatuar se ky OE nuk është i përgjegjshëm teknikisht konform kërkesave të specifikuara nga AK në dosjen e tenderit.

Në ofertën e OE janë bashkangjitur pjesërisht katalogjet e produkteve dhe specifikacioni teknik, ndërsa mungojnë katalogjet dhe specifikacioni teknik për disa produkte të kërkuara. OE ka prezentuar një listë të produkteve me modelet e ofruara.

Pretendimet tona për shkelje të dispozitave ligjore janë si në vijim:

1. Në dosje të tenderit, Seksioni II Fleta e të dhënave të Tenderit (FTD) është kërkuar tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, “4. *Lista e produkteve me broshurat ose katalog me specifikat teknike, e. Lista e produkteve me broshurat ose katalog me specifikat teknike, e nenshkruar dhe vulosur nga OE*”, OE i përzgjedhur për kontratë ka dorëzuar një listë të produkteve të ofertuara mirëpo që nuk përfshihen të gjitha paisjet sipas kërkesës tuaj në specifikimet teknike. Në këtë listë mungojnë modelet për: *Aplikacioni softuerik për votim elektronik dhe menxhim të sistemit (pako), TV 40”, TV 50”, PC desktop, Kabllo vazhdues të sistemit të mikrofonave*. Sipas RrUOPP udhëzohet se si duhet të veprojnë AK në rast se OE nuk dorëzon specifikacionin teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu, AK sipas nenit 28 të LPP-së, duhet të refuzoj tenderin pa kërkuar informacion të mëtutjeshëm
2. Në dosje të tenderit, Seksioni II Fleta e të dhënave të Tenderit (FTD) është kërkuar tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, “6. *Të ofrohet përshkrim i sistemit të punës të komplet ndërlidhëses së paisjeve dhe aplikacioneve, g. Plan i detajuar i punës së sistemit.Kopje.*”, përderisa OE i përzgjedhur për kontratë nuk ka dorëzuar një përshkrim apo plan të detajuar që përshkruan ndërlidhjen e sistemit por ka dorëzuar një deklaratë 1 faqe “Plani i instalimi të paisjeve” që përshkruan shkurtimisht në 5 pika veprimet e instalimit.
3. Njësia qendrore dhe digjitale e sistemit (Pozicioni nr.1).
 - a. Është ofertuar nga OE modeli VIS-DCP2000-D, mirëpo ky model nuk përmbush kërkesat teknike minimale të kërkuara nga ju në Aneksin 1. Në kërkesën teknike “*Të mundësojë delegatëve aktivizimin e mikrofonave me zë (sipas ndjeshmërisë dhe nivelit të zërit)*” modeli i ofruar nuk e mundëson një funksion të tillë pasi që në katalogun e prodhuesit për këtë model, thuhet se ky model përkrah këto mënyra diskutimi:
 - i. OPEN – të gjithë mikrofonat e lejuar të jenë aktiv
 - ii. OVERRIDE – i pari aktiv, tjetri deaktiv
 - iii. FREE – aktivizohen mikrofonat deri në maksimumin e lejuar
 - iv. APPLY – parashtron kërkesë për të folurNë dokumentacionin e dorëzuar nga OE nuk dëshmohet se posedon funksionin e aktivizimit me zë (Voice) ashtu siq është kërkuar në Aneks

1. Për më tepër, duke marr parasysh situatën e krijuar nga pandemia COVID 19, ky funksion i kërkuar është mëse i domosdoshëm për shkak se eviton prekjen fizike dhe të vazhdueshme të mikrofonit duke i mundësuar folësit aktivizim të mikrofonit përmes zërit pa pasur kontakt të vazhdueshëm me pajisjen.

- b. Kërkesa teknike “RS232 portin për lidhje me sistemin qendror dhe diagnostifikim”. Nuk posedon port RS232 për diagnozë dhe lidhje me sistem qendror ashtu siq është kërkuar në Aneks 1. Ky model posedon port DP9 (male & female) për konektim në sistemin e kamerës

Në vijim paraqesim në formë tabelare specifikacionin teknik që nuk plotëson për pozicionin nr.1

Njësia qendrore dhe digjitale e sistemit VIS-DCP2000-D	
nuk plotëson	
Të mundësoj delegatëve aktivizimin e mikrofonave me zë (sipas ndjeshmërisë dhe nivelit të zërit)	Nuk e plotëson
RS232 portin për lidhje me sistemin qendror dhe diagnostifikim	Nuk e plotëson

4. Njësia qendrore digjitale me rreze infra të kuqe (pozicioni nr.2)

- a. Është kërkuar “Të ketë së paku një emitues me rreze infra të kuqe, të integruar në pjesën e përprarmë të njësisë, për të mundësuar teknikut monitorim të kanaleve nga dhoma e paisjeve”, përderisa modeli i ofertuar VIS-VLI700A nuk posedon një të tillë dhe kjo paisje nuk i mundëson operatorit apo stafit të teknik të bëjë monitorim apo kontroll teknik nga dhoma e paisjeve, e cila është shumë e rëndësishme gjatë seancave të kujdeset për mbarëvajtjen e seancës.
- b. Është kërkuar “USB port për ruajtjen e shënimeve dhe instalimin e softuerit (upgrade)” përderisa VIS-VLI700A nuk posedon port USB që mundëson ruajtjen e shënimeve apo përditësim të softuerit të paisjes.
- c. Është kërkuar “Të ketë së paku një port Ø 3.5 mm për lidhje të kufjeve monitoruese” ndërsa ky model nuk posedon port të tillë dhe nuk i mundëson operatorit apo stafit të teknik të bëjë monitorim apo kontroll teknik nga dhoma e paisjeve, e cila është shumë e rëndësishme gjatë seancave të kujdeset për mbarëvajtjen e seancës.

Në vijim paraqesim në formë tabelare specifikacionin teknik që nuk plotëson për pozicionin nr.2

Njësia qendrore digjitale me rreze infra të kuqe VIS-VLI700A	
nuk plotëson	
Të ketë së paku një emitues me rreze infra të kuqe, të integruar në pjesën e përprarmë të njësisë, për të mundësuar teknikut monitorim të kanaleve nga dhoma e paisjeve	Nuk e plotëson
USB port për ruajtjen e shënimeve dhe instalimin e softuerit (upgrade)	Nuk e plotëson
Të ketë së paku një port Ø 3.5 mm për lidhje të kufjeve monitoruese	Nuk e plotëson

5. Radiator digjital me rreze infra të kuqe (pozicioni nr.3)

- a. Është kërkuar “Të ketë shumkanalësh, së paku 32 kanale shpërndarëse”, ndërsa modeli i ofertuar VIS-VLI701A nuk posedon 32 kanale dhe nuk është konform kërkesës tuaj.

Në vijim paraqesim në formë tabelare specifikacionin teknik që nuk plotëson për pozicionin nr.3

Njësia qendrore digjitale me rreze infra të kuqe VIS-VLI701A	
nuk plotëson	
Të ketë shumkanalësh, së paku 32 kanale shpërndarëse	Nuk e plotëson

6. Njësia digjitale e kryesuesit me mundësi votimi dhe selektor të kanaleve dhe Njësia digjitale e delegatit me mundësi votimi dhe selektor të kanaleve (pozicioni nr.4 dhe 5).

- Në listën e produkteve të OE, pozicioni nr.4. është ofertuar modeli VIS-DVCIC-T dhe poz.nr.5 modeli VIS-DVDIC-T, këto dy modele nuk plotësojnë kërkesat minimale teknike të kërkuara nga ju.
- Në kërkesën tuaj “Të jetë i paisur me filtër të integruar të frekuencave për të ndërprerë frekuencat e ulta nga audio sinjali nëse është e nevojshme” modeli i ofruar nga OE nuk e posedon fare një filtër të tillë.
- “Të jetë i paisur me lexues të integruar të kartelës identifikuese për delegatë”. Nuk ka fare slot për IC (ID) kartelë, në këtë model nuk mund të bëhet identifikimi i prezencës së delegatëve në sallë para fillimit të seancës për votim elektronik. Duke marrë parasysh kërkesën tuaj se posedimi i slot-it për identifikim të delegatit para nisjes së çdo seance të asamblesë komunale është shumë i rëndësishëm në shumë aspekte, siç janë: konfirmimi i prezencës së delegatit, kuorumi, të dhënat presonale vendosen në ID kartelë, rezultati individual i votimit pas përmbylljes së seancës së votimit, arkivimi digjital, atëherë ofrimi i një modeli që nuk posedon një funksion të tillë do duhej konsideruar si të papërgjegjshme dhe jo konform kërkesës teknike. Me këto modele të ofertuara, delegatët në sallë mund të votojnë pa u identifikuar paraprakisht në sistemin e prezencës me kartelë gjë që është në kundërshtim me kërkesën teknike.
- “Të jetë i paisur me selektor të kanaleve, butona për zgjedhjen e kanaleve të përkthimit dhe të dhënat e kanalit të paraqiten në displej”. Nuk ka buton të dedikuar për selektimin e kanaleve të përkthimit, por butonin nr.2 dhe nr.3 që janë dedikuar për votim mund të përdoren për selektim të kanaleve në rastin kur nuk lansohet procedura e votimit elektronik, në të kundërtën këta butona përdoren për votim. Gjatë procedurës së votimit këta butona nuk mund të përdoren për selektimin e kanalit të përkthimit.
- “Të ketë buton për rregullimin e nivelit të zërit (volulmit) në rast të kycjes së kufjeve”. Nuk ka buton të dedikuar për rregullimin e nivelit të zërit, por butonin nr.4 dhe nr.5 që janë dedikuar për votim mund të përdoren për rregullim të nivelit të zërit në rastin kur nuk lansohet procedura e votimit elektronik në të kundërtën këta buton përdoren për votim. Gjatë seancës së votimit këta butona nuk mund të përdoren për rregullim të nivelit të zërit.

Në vijim paraqesim në formë tabelare specifikacionin teknik që nuk plotëson për pozicionin nr.4 dhe nr.5

Njësia digjitale e kryesuesit me mundësi votimi dhe selektor të kanaleve– VIS-DVCIC-T dhe Njësia digjitale e delegatit me mundësi votimi dhe selektor të kanaleve – VIS-DVDIC-T	
---	--

nuk plotëson	
<i>Të jetë i paisur me filtër të integruar të frekuencave për të ndërprerë frekuencat e ulta nga audio sinjali nëse është e nevojshme</i>	Nuk e plotëson
<i>Të jetë i paisur me lexues të integruar të kartelës identifikuese për delegatë</i>	Nuk e plotëson
<i>Të jetë i paisur me selektor të kanaleve, butona për zgjedhjen e kanaleve të përkthimit dhe të dhënat e kanalit të paraqiten në displej</i>	Nuk e plotëson
<i>Të ketë buton për rregullimin e nivelit zërit (volumit) në rast të kyçjes së kufjeve</i>	Nuk e plotëson

7. Njësia digjitale e delegatit me selektor të kanaleve (pa mundësi votimi) pozicioni nr.6

- a. Është kërkuar “Të jetë i paisur me filtër të integruar të frekuencave për të ndërprerë frekuencat e ulta nga audio sinjali nëse është e nevojshme” modeli i ofruar VIS-DID-T nuk e posedon fare një filtër të tillë.

Në vijim paraqesim në formë tabelare specifikacionin teknik që nuk plotëson për pozicionin nr.6

Njësia digjitale e delegatit me selektor të kanaleve (pa mundësi votimi) VIS-DID-T	
nuk plotëson	
<i>Të jetë i paisur me filtër të integruar të frekuencave për të ndërprerë frekuencat e ulta nga audio sinjali nëse është e nevojshme</i>	Nuk e plotëson

8. Njësia digjitale e përkthyesit simultan (pozicioni nr.8)

- a. Është kërkuar “Njësia për përkthim simultan e formatit digjitale dhe sipas standardi IEC 60914, ISO 2603 dhe ISO 4043”, modeli i ofertuar VIS-INT64 nuk plotëson kërkesat konform standardeve të kërkuara.
- b. Është kërkuar “Të ketë butonin dhe funksionin përsëritës (repeat)” ndërsa modeli VIS-INT64 nuk posedon një buton dhe funksion të tillë. Një funksion i tillë alarmon folësin në sallë që të përsërisë fjalimin në rast se përkthyesi nuk mundet të përkthejë. Ndërsa modeli i ofertuar nuk ofron një funksion të tillë.
- c. Është kërkuar “Të ketë funksionin e ngadalësimit (slow alert) që paralajmëron folësin të flasë më ngadalë në rast se përkthyesi nuk mund të përcjell me përkthim”, modeli VIS-INT64 nuk posedon një funksion të tillë, pra në rast se përkthyesi nuk mund të përcjell folësin për shkak të shpejtësisë së fjalimit, atëherë përkthyesi nuk mund të alarmojë folësin që të ngadalësojë fjalimin, një funksion i tillë nuk ofrohet në modelin e ofertuar nga OE.

Në vijim paraqesim në formë tabelare specifikacionin teknik që nuk plotëson për pozicionin nr.8

Njësia digjitale e përkthyesit simultan VIS-INT64	
nuk plotëson	
<i>Njësia për përkthim simultan e formatit digjitale dhe sipas standardi IEC 60914, ISO 2603 dhe ISO 4043</i>	Nuk e plotëson
<i>Të ketë butonin dhe funksionin përsëritës (repeat)</i>	Nuk e plotëson
<i>Të ketë funksionin e ngadalësimit (slow alert) që paralajmëron</i>	Nuk e plotëson

folësin të flasë më ngadalë në rast se përkthyesi nuk mund të përcjell me përkthim

9. Kufje për njësitë e delegatëve (pozicioni nr.12)

- a. Është kërkuar “*Frekuenca e reagimit të jetë nga 20Hz deri 20kHz*” ndërsa modeli i ofertuar VIS-HPD mundëson prej 80Hz deri 2kHz, dmth nuk është në kuadër të brezit frekuencor të kërkuar.

Në vijim paraqesim në formë tabelare specifikacionin teknik që nuk plotëson për pozicionin nr.19

Kufje për njësitë e delegatëve VIS-HPD	
nuk plotëson	Oferton
<i>Frekuenca e reagimit të jetë nga 20Hz deri 20kHz</i>	Nuk plotëson

10. Njësia digjitale e përforcimit të zërit (Pozicioni nr.13). Në listën e produkteve të OE është ofruar modeli VIS-CDA-4, amplifikator i fuqisë së zërit dhe nuk plotëson kërkesat minimale teknike të kërkuara nga AK sipas specifikave teknike të dosjes së tenderit.

- a. Është kërkuar “*Të jetë i prodhuar sipas standardit IEC 61603-7 dhe IEC 60914*”, modeli i ofertuar nuk plotëson funksionet sipas standardeve të kërkuara pasi që nuk është teknologji digjitale dhe e transmetimit me rreze infra të kuqe.
- b. Është kërkuar “*Të ketë USB port për të mundësuar regjistrimin e zërit*” nuk posedon një port të tillë që mundëson regjistrim të zërit.
- c. Është kërkuar “*Të ketë ekran për kontroll të regjimit të punës dhe konfiguracionit*” nuk posedon ekran që mundëson kontroll të regjimit të punë dhe konfigurimit të paisjes.
- d. Është kërkuar “*Të ketë përkrahje për së paku dy mikrofona ajror*” nuk përkrah lidhjen direkte të mikrofonave ajror.
- e. Është kërkuar “*Të ketë të integruar BNC konektor për lidhje me paisjet infrared dhe të jetë kompatibil me njësinë qendrore të mikrofonave konferencial*” nuk plotëson këtë kërkesë pasi që kjo paisje e ofertuar nuk ofron teknologji digjitale të transmetimit të audio sinjalit me rreze infra të kuqe
- f. Është kërkuar “*Të ketë së paku dy audio linja në hyrje dhe dalje dhe një RS232 port për lidhje me sistem të kontrollit*” nuk posedon fare një port të tillë RS232.

Në vijim paraqesim në formë tabelare specifikacionin teknik që nuk plotëson për pozicionin nr.13

Njësia digjitale e përforcimit të zërit VIS-CDA-4	
nuk plotëson	Oferton
<i>Të jetë i prodhuar sipas standardit IEC 61603-7 dhe IEC 60914</i>	Nuk plotëson
<i>Të ketë USB port për të mundësuar regjistrimin e zërit</i>	Nuk plotëson
<i>Të ketë ekran për kontroll të regjimit të punës dhe konfiguracionit</i>	Nuk plotëson
<i>Të ketë përkrahje për së paku dy mikrofona ajror</i>	Nuk plotëson
<i>Të ketë të integruar BNC konektor për lidhje me paisjet infrared dhe të jetë kompatibil me njësinë qendrore të mikrofonave konferencial</i>	Nuk plotëson
<i>Të ketë së paku dy audio linja në hyrje dhe dalje dhe një RS232</i>	Nuk plotëson

port për lidhje me sistem të kontrollit

11. Altoparlantë muri në formë kolone (Pozicioni nr.14)

- a. Është kërkuar “Të ketë tension konstant 100/70V”, modeli i ofertuar VIS-SPK-C4.3 nuk plotëson një kërkesë të tillë.

Në vijim paraqesim në formë tabelare specifikacionin teknik që nuk plotëson për pozicionin nr.14

Altoparlantë muri në formë kolone VIS-SPK-C4.3	
nuk plotëson	Oferton
Të ketë tension konstant 100/70V	Nuk plotëson

12. Ndërsa sipas kërkesës në specifikimet teknike të kërkuaranga AK, OE i përzgjedhur për kontratë nuk ka dorëzuar specifikacion teknik, model, broshurë apo katalog dhe nuk janë paraqitur fare në listën e produkteve të ofertuara produktet tjera siç janë:

- Aplikacioni softuerik për votim elektronik dhe menxhim të sistemit (pako)
- TV 40”
- TV 50”
- PC desktop
- Kablllo vazhdues të sistemit të mikrofonave

Pra, për këto produkte mungojnë të dhënat dhe specifikacioni teknik nga të cilat AK është dashur të bën vlerësim teknik të këtyre pozicioneve. Sipas RrUOPP udhëzohet se si duhet të veproj AK në rast se OE nuk dorëzon specifikacionin teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu, AK sipas nenit 28 të LPP-së, duhet të refuzoj tenderin pa kërkuar informacion të mëtutjeshëm

Duke u bazuar në krahasimet e lartëpërmendura shihet se komisioni i vlerësimit të ofertave të AK-së nuk ka bërë vlerësim të drejtë të tenderit. Të gjitha gjetjet e lartë përmendura paraqesin shkelje të dispozitave ligjore neni 7, 28 dhe 59 të LPP-së.

Andaj kërkojmë nga Organi Shqyrtues i juaj të marrë për bazë të gjitha argumentet e faktuara më sipër dhe të konstatoji shkeljet e lartëpërmendura dhe të urdhëroni AK të kthejë lëndën në rivlerësim duke u bazuar në kriteret dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dosje të tenderit dhe konform LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasojë e këtyre shkeljeve ligjore të kryera nga AK, ne si OE do të pësojmë dëme si: fitimin e humbur, dëmtim të raportëve me prodhuesin , dëmtim të reputacionit afarist dhe dëme tjera materiale si përgatitja e tenderit, ankesës, etj., dhe dëme tjera jomateriale.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë”
- b) kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës”
- c) kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm
- d) kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve
- e) kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*